MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E TREGTISË, EKONOMISË DHE ENERGJITIKËS

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në **METE** me objekt: "*Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë dhe vlerësimin e aktivitetit ekonomiko-financiar, për periudhën 1/1/2010 deri 30/6/2011"* dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 40, datë 26/03/2012.
Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 336/7, datë 26/03/2012 dërguar ***Z. Nasip Naço, Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës,*** krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nisur nga fakti se, në kundërshtim me Urdhrin e Kryeministrit nr. 174, datë 1/10/2010 "Për marrjen e disa masave për përmirësimin e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil në ministritë dhe Aparatin e Këshillit të Ministrave", janë marrë 40 punonjës të emëruar përkohësisht (të komanduar) pa status të nëpunësit civil;
Rekomandoj që, në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore për statusin e nëpunësit civil, vendimit të KM nr. 474, datë 16.06.2011 "Për përcaktimin e standardeve e të procedurës që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike", si dhe urdhrit të sipërcituar, të merren masa për plotësimin e vendeve vakant të cilët janë plotësuar me kontrata të përkohëshme, që aktualisht u ka kaluar afati ligjor

Menjëherë

2. Nisur nga fakti se detyrimet debitore kanë ardhur nga viti në vit në rritje, rekomandoj që METE, të marrë masa dhe të kërkojë me rrugë ligjore, arkëtimin e detyrimeve debitore të cilët në fund të vitit 2010, rezultojnë në shumën 794,311 lekë.

Në vijimësi

3. Duke marrë shkas nga llogaritja gabim e normave të amortizimit për Aktivet e Qëndrueshme të Trupëzuara për vitin 2010, rekomandoj që Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve të bëjë rillogaritjen e amortizimit për inventarin ekonomik dhe mjetet e transportit në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Menjëherë

4. Të ardhurat e realizuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe që rezultojnë gjendje në fund të vitit 2010, në llogarinë 512 "Llogari në bankë" në shumën 670 mijë lekë, **rekomandoj që**, të derdhen në buxhetin e shtetit.

Menjëherë

5. Duke marrë shkas nga mangësitë e konstatuara në lidhje me mos funksionimin e strukturës së Njësisë së Prokurimit, si strukturë më vete në organikën e ministrisë, detyrë e rekomanduar dhe në kontrollin e kaluar dhe e pa zbatuar, **rekomandoj,** ngritjen menjëherë të kësaj strukture e cila të ketë detyrë funksionale procesin e prokurimit dhe të administrojë në mënyrë të vazhdueshme gjithë procesin.

Menjëherë

6. Duke marrë shkas nga konkurrenca e pakët në tenderat e konsulencës, anulimin disa herë të procedurave të përcaktuara, si dhe faktin se, nga Autoriteti Kontraktor për kryerjen e këtyre shërbimeve është kërkuar shoqëri këshilluese ndërkombëtare dhe se "Ftesa për shprehje interesi", nuk është publikuar në një gazetë ndërkombëtare, **rekomandoj që,** për rritjen e konkurrencës dhe trasparencës në shërbimet e konsulencës të kryera nga METE, nga juristët të gjenden hapësirat ligjore për publikimin e "Ftesës për shprehje interesi", në një gazetë ndërkombëtare.

Vazhdimisht

7. Nisur nga konstatimet e bëra gjatë kontrollit të procedurave të prokurimit të shërbimeve të konsulencës, nga ku rezultoi se, vlerësimet e propozimeve teknike janë bërë në total, nuk janë të argumentuara, të qarta dhe nuk janë të shoqëruara me aktvlerësimin nga çdo anëtar të komisionit, **rekomandoj që:**
Nga strukturat përkatëse të METE-s të hartohen metodika dhe të vendosen nënkritere brenda kritereve të vlerësimit "Përvoja në punë të ngjashme e konsulentit", "Metodologjia e propozuar", "Kualifikimet e stafit të propozuar" dhe "Transferimi i njohurive", me qëllim bërjen transparente dhe të besueshme të vlerësimeve të propozimeve teknike.

Vazhdimisht

8. Për menjanimin e konstatimit të evidentuar dhe në kontrollin e vitit të kaluar, përkatësisht, mungesën në dosjen e prokurimit të preventivit të kostos dhe të fondeve të buxhetit që nevojitet për të përmbushur detyrën, si dhe mungesën e projektkontratës me përkufizime të qarta të objektivave, të qëllimeve dhe synimit të detyrës, ku të përfshihen informacione kryesore për kandidatët e interesuar dhe rezultatet e pritura nga shërbimi që do të jepet, **rekomandoj që,** strukturat përkatëse të METE-s, siç është Sektori i Prokurimeve të bëjnë të mundur administrimin e këtyre dokumentave të rëndësishme në dosjet e prokurimit.

Menjëherë

9. Marrë shkas nga mosadministrimi në dosjen e prokurimit, për përzgjedhjen e kandidatëve në rastin e zgjedhjes së procedurës së prokurimit "Negocim pa shpallje paraprake" të listave paraprake, **rekomandoj që,** METE të krijojë një database (shortlistë) me të dhëna të grumbulluara nga organet e specializuara si Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Qendra Kombëtare e Regjistrimit apo institucione të tjera, në mënyrë që përzgjedhja e kandidatëve për t`i ftuar në konkurrim të jetë transparente dhe e besueshme.

Vazhdimisht

10. Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në të ardhmen në Programet e Auditimit në zbatim të dispozitave ligjore, të parashikojë dhe regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të shtetit në administrim të Aparatit të Ministrisë dhe strukturave të saj vartëse.

Vazhdimisht

11. Për të metat dhe mangësitë e konstatuara nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, gjatë auditimit të subjekteve për shkeljet e konstatuara sipas natyrës së tyre, të përcaktohet dhe të vendoset baza ligjore.

Vazhdimisht

12. Me përfundimin e auditimit dhe evadimit të materialeve të auditimit, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, të marrë masa për të arkivuar dosjet e auditimit në arkivin e institucionit në përputhje me ligjin nr. 9154, datë 6/11/2003 "Për arkivat" dhe Manualin e Auditimit të Brendshëm miratuar me VKM nr. 345, datë 1/6/2004 "Për miratimin e Manualit të Procedurave të Auditimit të Brendshëm.

Vazhdimisht

13. Administrata e METE-s, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, të marrë masa për vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të atyre mallrave stok të cilët kanë humbur cilësinë dhe vlerën e përdorimit dhe që ndodhen gjendje që para vitit 2005, gjithsej 153 artikuj me vlerën 2,986,455 lekë. Për materialet që vlerësohen si materiale mbeturinë, skarco, rikupero, etj., të jepen për përdorim të mëtejshëm në destinacionet që cakton vetë institucioni.

Menjëherë

B. <u>MASA PËR SHPËRBLIM DËMI</u>

1. Duke marrë shkas nga mbarimi i afatit të sigurimit të kontratës më datë 29/11/2010 dhe moskërkesën nga METE, për shtyrje vlefshmërie të këtij afati për zbatimin e kontratës "*Shërbim Konsulence për përzgjedhjen e shoqërisë*

këshilluese ndërkombëtare që do të asistojë në procesin e privatizimit të paketës së aksioneve shtetërore në shoqërinë Albtelekom sh.a.”, kontratë e cila ka mbetur pa u zbatuar, **rekomandoj që,** METE, të kërkojë në rrugë ligjore shpërblimin e dëmit ekonomik **me vlerë 9,500 euro,** të shkaktuar nga [redacted] duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit.

Menjëherë

2. Nisur nga mosrespektimi i afateve në realizimin e kontratës nga konsulenti [redacted] për tenderin “Shërbim konsulence për kontratën e koncesionit për shfrytëzimin e potencialit energjetik të lumit Vjosë”, **rekomandoj që**, METE të kërkojë në rrugë ligjore shpërblimin e dëmit ekonomik **me vlerë 119,695 lekë,** të shkaktuar nga konsulenti [redacted] duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

Bazuar në nenin 25, të Kreut VIII “Masat disiplinore” të ligjit nr. 8549, datë 11/11/1999 “Statusi i nëpunësit civil”, si dhe në pikat 1 e 2 të VKM nr. 306, datë 13/6/2000 “Për disiplinën në shërbimin civil”, i ***rekomandoj Titullarit të Ministrisë*** *dhënien e masave disiplinore:*

“Kalim në një detyrë të një niveli apo klasë më të ulët për një periudhë 1 vit”, neni 25, pika 3, germa “ç”, për:

1. [redacted] ***me detyrë Sekretar i Përgjithshëm,*** për shkeljet e konstatuara në emërimin e punonjësve, në kundërshtim me Urdhrin e Kryeministrit nr. 174, datë 1/10/2010 “Për marrjen e disa masave për përmirësimin e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil në ministritë dhe Aparatin e Këshillit të Ministrave”, pasi janë marrë në punë 40 punonjës të emëruar përkohësisht (të komanduar) pa status të nëpunësit civil.

“Vërejtje me shkrim”, neni 25, pika 3, germa “a”, për:

1. [redacted] ***me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Politikave të Zhvillimit Ekonomik,*** në cilësinë e ish-Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimeve Mbështetëse, për shkeljet e konstatuara në emërimin e punonjësve, në kundërshtim me Urdhrin e Kryeministrit nr. 174, datë 1/10/2010 “Për marrjen e disa masave për përmirësimin e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil në ministritë dhe Aparatin e Këshillit të Ministrave”, pasi janë marrë në punë 40 punonjës të emëruar përkohësisht (të komanduar) pa status të nëpunësit civil.

2. [redacted] ***me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse,*** për shkeljet e konstatuara në emërimin e punonjësve, në kundërshtim me Urdhrin e Kryeministrit nr. 174, datë 1/10/2010 "Për marrjen e disa masave për përmirësimin e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil në ministritë dhe Aparatin e Këshillit të Ministrave", pasi janë marrë në punë 40 punonjës të emëruar përkohësisht (të komanduar) pa status të nëpunësit civil.

"Vërejtje me paralajmërim", neni 25, pika 3, germa "b", për:

1. [redacted] ***me detyrë Drejtore e Shërbimeve Mbështetëse,*** për shkeljet e konstatuara në emërimin e punonjësve, në kundërshtim me Urdhrin e Kryeministrit nr. 174, datë 1/10/2010 "Për marrjen e disa masave për përmirësimin e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil në ministritë dhe Aparatin e Këshillit të Ministrave", pasi janë marrë në punë 40 punonjës të emëruar përkohësisht (të komanduar) pa status të nëpunësit civil.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Aleksandër Tereziu Përgjegjës Grupi, Din Zenelaj, Yllka Dede, Nerënxa Llapashtica dhe Ilirjan Çukaj. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit zj. Luljeta Nano, Drejtori i Departamentit z. Ded Trieshi dhe Drejtore e Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë zj. Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm z. Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT